

# STATUTI

## SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“All Services Europe” Sh.p.k**

### NENI 1

Shoqëria është krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj në përputhje me normat e akt themelimit, këtij statuti, Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit ne fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër ortaku shoqërisë krijon statutin e shoqërisë si mëposhtë vijon:

### EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

#### NENI 2

##### **Emri**

Emri i shoqërisë së themeluar do të jete **“All Services Europe” Sh.p.k**

#### NENI 3

##### **Selia**

Selia dhe veprimtaria e e shoqërisë do të jene në adresën Rruga : Njesia Bashkiake nr 7, Rruga Ndre Mjeda, Pall.5, SH1, AP1, Tirane.

Shoqëria mund e ka të drejte të ndryshojë seline e saj si dhe të hape ose mbylle adresa dytësore si degë të saj.

#### NENI 4

##### **Objekti**

1. Import eksport te mallrave industriale, ushqimore, prodhime bujqesore e blegtorale, prodhim e shitje pije alkolike etj dhe tregtim te materialeve te ndertimit dhe te paisjeve te ndertimit ne teresi, prodhimi dhe ambllazhimi i prodhimeve kimike, import te artikujve te kozmetikës, materiale dentare, pajisje dhe ndihmese mjeksore spitalore paisje laborator mjekesore, reagent dhe higjenes personale. Import eksport dhe tregtim te detergjenteve dhe materialeve te pastrimit. Tregtim, import, eksport te produkteve dhe nen produkteve te duhanit, duke perfshire por pa u kufizuar ne: paketa cigaresh, duhan te hapur, leter e filter per cigare, aksesore per duhanin etj. Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

NENI 5  
**Kohëzgjatja**

Veprimtaria e shoqërise është pa afat. Kjo kohëzgjatje mund të ndryshohet nga themeluesit e saj me vendim të asamblese se pergjithshme.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërise është 50,000 (pesedhjetë mijë ) leke, i cili përbëhet nga kontributet e ortakeve dhe ka 2 (dy) kuota.

Pjesa takuese e ortakut themelues është:

- a) Znj. Isabelle Montpellier zoteron 60 % (gjashtedhje përqind) te kuotës e të kapitalit, duke pasur ne pronesi nje kuote.
- b) Z. Saiti Ridvan zoteron 40 % (dyzete përqind) te kuotës e të kapitalit, duke pasur ne pronesi 1 (nje) kuote.

NENI 7

Kapitali themeltar mund të shtohet ose zvogëlohet vetëm me vendim të ortakeve. Shtimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të bëhet në varesi të rezultateve ekonomike e në perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

NENI 8

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka ortaku themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 9

Ortaku mund të lëre peng, si barrë siguroese apo si garanci kuotat e zotëruara në këtë shoqëri vetëm pas marrjes së një vendimi unanimit nga ana e asamblese se pergjithshme.

NENI 10

Forma ligjore e shoqërise: Shoqëri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.)

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka ortaku themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 11  
**Transferimi kuotave**

Kuotat e kapitali themeltar, që ato përfaqësojnë, mund të transferohet me anë të shitjes dhurimit apo çdo mënyre tjetër të njohur nga legjislacioni Shqiptar vetëm më vendim unanimit të ortakeve. Bën përjashtim nga ky rregull vetëm kalimi me trashëgimi. Transferimi tek persona të tretë, shqiptar apo të huaj, i pjesëve të kapitalit dhe kuotës që ato përfaqësojnë, bëhet me vendim unanimit të ortakeve.

NENI 12

Shoqëria mund të ketë dhe kontribute të tjera në natyrë. Ketu përfshihen të gjitha sendet e paluajtshme në shërbim të shoqërisë si dhe ato të luajtshme, të cilat kalojnë në pronësi të shoqërisë.

FONDET E SHOQËRISË

NENI 13

Shoqëria përcakton si fonde elementët e mëposhtëm:

- 1) Fondi themeltar (qarkullues);
  - 2) Fondi rezervë;
  - 3) Fonde të tjera që mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj.
- Madhësia e secilit fond përcaktohet mbi bazën e vendimit të Asamblesë së ortakëve, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qelimin e përdorimit të tij.

DREJTIMI ADMINISTRATIV.

NENI 14

Shoqëria ka si organe të saj:

- a) Asamble e përgjithshme dhe
  - b) Administratorin, si përfaqësues ligjor.
- Renditja e mësipërme shpreh dhe hierarkinë e organeve drejtuese të shoqërisë.

NENI 15

Administrator i shoqërise do jete Znj. Isabelle Montpelier.

E gjithë veprimtaria e shoqërise administrohet nga administratori në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi. Administratori zgjidhet për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data 08.03.2022 – 07.03.2027.

#### NENI 16

Administratori shoqërise ka në kompetencë të emergjente, si përfaqësues të shoqërise, vetëm punonjës të saj për realizimin e detyrave të rëndësishme në interes të shoqërise. Kompetencat e personave të autorizuar përcaktohen në aktin e autorizimit të posaçëm. Për veprimtari si aplikime për vertetime pranë organeve shtetërore, aplikime të çdo lloji pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dorëzime bilancesh, aplikime të ndryshme pranë organeve tatimore mund të kryhen nga persona të tretë, jo punonjës të shoqërise, të pajisur me autorizim të posaçëm.

#### NENI 17

Shoqëria nuk merr përsipër veprimet e pasojat që vijnë prej tyre, të kryera nga të autorizuarit në tejkallim të kompetencave të përcaktuara në autorizim.

Ky rregull vlen dhe për Administratorin që tejkallon kompetencat që i janë dhënë nga ligji e nga ky statut.

#### NENI 18

Veprimtaria e shoqërise, administrohet nga administratori në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 19

Administratori për shqyrtimin e bilancit vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabel, emeron një ose disa eksperte kontabel.

### ASAMBLEJA PERGJITHSHME

#### NENI 20

#### **Të drejtat dhe detyrimet**

Asambleja është organi më i lartë vendimarrës i shoqërise. Vendimet e Asamblesë merren vetëm me unanimitet votash.

Asambleja ka si kompetencë:

- a) përcaktin e politikave tregëtare të shoqërise,
- b) miratim e ndryshimeve të statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- ç) përcaktimin e kompetencave të administratorit në aktin e emerimit,

- d) përcaktimin e shpërblimit të administratorit, likujduesit dhe ekspertëve të fushave të ndryshme.
- dh) mbikqyrjen, zbatimin e politikave tregtare nga administratorët,
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, raporteve të ecurisë së shoqërisë,
- ë) zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit,
- f) shqyrtimin e bilancit vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar,
- g) vendosjen për krijimin e filialeve, degeve ose përfaqësive të shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashketa,
- gj) vendosjen për marrjen e kredive si dhe mbarimin e aktivitetit të shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqërisë vlerësohen me humbje,
- h) realizimin e marrdhënieve të rëndësishme financiare dhe ekonomike të shoqërisë, me persona të tjere fizike ose juridike,
- i) emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit teknik të shoqërisë, sipas drejtimeve të veprimtarisë që do ushtroje shoqëria,
- l) riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërisë,
- j) emërimin e përfaqësuesve të shoqërisë para gjykatës.

#### NENI 21

#### Mbledhja asamblesë së ortakëve

Asambleja mbledhet sa here që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, në rastet e përcaktuara me ligj, por gjithmonë jo më pak se një herë në vit.

Ajo thirret nga administratori ose ortakët e shoqërisë.

Thirrja bëhet me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike zyrtare të ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, ditën, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e tu dërgohet ortakëve jo më vonë se shtatë ditë para datës së parashikuar për mbledhje.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamble, vete ose nga një person i autorizuar prej tij me prokurë, ose ortak tjetër.

#### ADMINISTRATORI

#### NENI 22

#### Kompetencat dhe kufizimet e Administratorit

- Administratori shoqërisë ka për detyrë dhe si kufizim të kompetencave të tij si mëposhte:
  - a) të punoje, drejtojë e organizojnë në mënyrë të tillë shoqërinë, që të sigurojnë suksesin e saj në veprimtarinë ekonomiko-financiare që ajo kryen;
  - b) të ndjekin politikën tregtare të vendosur nga asambleja e ortakëve;
  - c) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët;
  - ç) të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave administrative, shkresave e dokumentave privatë të shoqërisë, e të librave kontabël të shoqërisë;

- d) të hartojë e nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe vazhdimësisë së saj, së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimeve dhe paraqitjen e këtyre dokumentave para asamblese së ortakëve për miratim;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dergoje të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligj, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- e) nënshkruan kontratat e punës me punëmarrësit;
- f) ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhëniet me organet e ndryshme shtetërore dhe me personat e tjere fizike e juridike;
- g) lidh kontrata me të treta për interesa të shoqërisë, vetëm miratimin me shkrim të asamblese;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë para gjykatës;
- h) miraton rregulloren e punës;
- i) emeron specialist të fushave të ndryshme si drejtësia, ekonomia, financat etj. për përfaqësimin e shoqërisë përpara gjykatave, organeve administrative, shoqërive të tjera private për realizimin dhe mbrojtjen e interesave të shoqërisë;
- j) të reagojë menjëherë publikisht dhe pranë organeve administrative nëse shikon se keqpërdoret emri i shoqërisë, ortakëve, punonjësve apo vetë administratorit të saj;
- k) të transferojë nga llogaritë bankare të shoqërisë drejt subjekteve të treta, vetëm shumat e nevojshme për pagimin e taksave, tatimeve, pagave, sigurimeve shoqërore, faturave tatimore të konfirmuara se janë të vlefshme për shoqërinë; .

- Administratori shoqërisë nuk mund:

- i) të transferojë para nga llogaritë e shoqërisë në llogaritë e familjarve të tij, farefisit të tij, bashkeshortes, femijeve, krushqine dhe shoqërisë së tij.
- ii) të terheqë para në dorë nga llogaritë bankare të shoqërisë apo të pranojë pagesa në para nga persona me të cilët shoqëria kryen veprimtari tregtare.
- iii) të miratojë publikimin e lajmeve dhe/ose informacioneve të gabuara, të pasakta, fallco apo të rreme për llogaritë të shoqërisë apo të lejojë që stafi që ai do mbikqyrë të bëjë një gjë të tillë. Nëse ky fakt ndodh përgjegjësinë financiare dhe administrative për këtë gjë e mban administratori.
- iv) të shesë apo blejë aset të shoqërisë, pasuri të luajtshme e të paluajtshme të shoqërisë pa miratimin me vendim të shkruar të ortakëve themelues.
- v) nuk mund të përhapë lajme denigruese, shpifese, të pavërteta apo që cenojnë imazhin e shoqërisë gjatë kohës që është në funksionin e Administratorit si dhe pas përfundimit të këtij funksioni.
- vi) të përvetësojë ose marrë informacione konfidenciale, shkruesore, të shkruara, në format elektronik dhe as të shpërndajë në asnjë lloj rruge si me botim në internet, lajme audio pamore, emisione radiofonike ose televizive informacione konfidenciale. Nga ky rast bëjnë përjashtim rasti kur kjo i kërkohet nga organe si prokuroria.

## DREJTIMI TEKNIK I SHOQËRISË

### NENI 23

Per veprimtari në fusha të veçanta (në të cilat ligji përcakton drejtim nga specialistet të licensuar), shoqëria do të punësojë me kontrata pune specialist të licensuar sipas fushës perkatese.




## MARRDHËNIET FINANCIARE

### NENI 24

Shoqëria ka të drejte të hape llogari rrjedhëse, kursimi e depozite pranë bankave të vendit ose të huaja në shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likuidimit të furnitorëve të saj e të paguhet, për shërbimet që ofron, nëpërmjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejte të financohet në leke ose valute të huaj.

### NENI 25

Shoqëria përgjigjet për kontributet fiskale, sigurimet shoqërore dhe afatet e derdhjes së tyre. Personat e ngarkuar me këto detyra duhet të mbajnë dokumentacinë të rregullt financiar.

Ne fund të vitit financiar, Administratori duhet të dorëzojë pranë organeve tatimore përkatëse bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

## MARRDHËNIET E PUNESIMIT

### NENI 26

Administratori vendos për personat që do punësohen në aktivitetin e shoqërisë. Punësimi do bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarresit.

### NENI 27

Marrdhëniet e punësimit do rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet midis paleve, në bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, pageses, sigurimit në punë, ditëve të pushimit etj.

### NENI 28

Ortaket, Administratori dhe personeli i shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me ligjin.

Çdo punonjës i shoqërisë është përgjegjës për kryerjen e detyrës, e përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit.

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masat disiplinore të parashikuara nga Kodi i Punës.

## KONFIDENCIALITETI

### NENI 29

Të gjithë personat e punësuar në shoqeri janë të detyruar të ruajnë fshehtesine e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjetër konfidencial, me përjashtim të rastit kur këto informacione janë të jashtligjshme, shkelin normat e moralin e përgjithshëm të shoqërise apo përbëjnë veper penale.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### NENI 30

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve ndaj personave të trete, kalojne ne dispozicion të ortakëve.

### NENI 31

Pagesat e tatimeve dhe sigurimeve shoqerore të personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes.

### NENI 32

Në rast mbarimi të veprimtarise së shoqërise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojne në dispozicion të ortakeve sipas mases së kuotave që zoterojne në shoqeri.

## PËRFUNDIMI SHOQËRISE

### NENI 33

#### **Shkrirja**

Shoqëria mbaron me te perfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, me ane të një vendimi të asamblese së përgjithshme dhe per shkak të falimentimi.

### NENI 34

#### **Likujdimi**

Në rast përfundimi, shoqëria do ti nënshtrohet procedurave të likujdimit.

Për të administruar këte procedure, asambleja e përgjithshme e ortakeve emeron një ose disa likuidatore, të cilet paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqërise, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme për të përfunduar likujdimin.



## DISPOZITA TE FUNDIT

### NENI 35

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, plotësimi dhe drejtimi i veprimeve bëhet duke iu referuar Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” i ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër në fuqi të legjislacionit shqiptar.

### NENI 38


Ky statut u përpilua nga ortakët themelues të shoqërisë me vullnetin e tyre të plote e të lire.

Statuti u hartua në dy kopje të njehta, në përmbajtje e fuqi ligjore, ku një kopje do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.


**Tiranë më 08.03 .2022**

## **ORTAKET THEMELUES**

**Isabelle Montpelier**  
Administrator/e

  
~~Isabelle Montpelier~~

**Saiti Ridvan**

  
SAITI RIDVAN